

PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE PËR AKTIVITETIN

**PRODHIMI I USHQIMEVE DHE PIJEVE DHE VEPRIMTARITË E
LIDHURA ME TO**

**ID 7.7/a THERTORE DHE ID 7.8/b RITJE INTENSIVE E DERRAVE NË
NJË INSTALIM**

**KAPACITETI PRODHUES I KARKASAVE ËSHTË I BARABARTË ME 50
TON/DITË OSE MË PAK SE KAQ, POR GJITHSESI MË SHUMË SE 2
TON/DITË DHE MBARËSHTIMIN I DERRAVE KAPACITETI 200
DERRA NEN 20 KG**

“ MUHARREM HOXHA ”

NIPT K73005015D

**VENDNDODHJA: BERAT, LAGJJA DUSHNIK, RRUGA
NACIONALE BERAT - URA VAJGURE, GODINA ME NR.
PASURIE 1365/13, ZONA KADASTRALE NR.1587.**


P.F Muharrem Hoxha me NUIS K73005015D dhe administratior te subjektit Muharrem Hoxha eshte i pajisur me leje mjedisi tipi B me PN-5850-07-2013 per veprimtarine Mbarështim dhe import kafshësh të gjalla (Derra) me vendndodhje Berat, Otlak, Lapardha si dhe leje mjedisi tipi C me PN-6231-01-2018 dhe me veprimtari Thertore dhe vendndodhje Berat, Lagjja Dushnik, rruga nacionale Berat - Ura Vajgurore, godina me nr. pasurie 1365/13, zona kadastrale nr.1587

Duke qene se lejet e mjedisit tipi C per te cilen ka qene i pajisur per veprimtarine thertore, kerkojme te aplikojme per leje te re mjedisi tipi B per veprimtarite thertore dhe rritje intensive e derrave.


Objekti ndodhet në zonën kadastrale Nr. 1587, prona ka numër pasurie 1365/13 Bashkia Berat dhe shtrihet në një sipërfaqe totale prej 696.60m2.

Projekti propozon funksionimin e veprimtrise se thertores dhe rritjes se derrave

Zona me interes, e cila merret në studim për të vlerësuar propozimin e zhvillimit në të, ndodhet përgjatë rrugës “Dushnik-Berat”, afër Lumit Osum. Ka një distancë nga qendra e qytetit prej 3.93 km. Ajo ka një fushë pamje të bukur në drejtim të jug-perendimit dhe pjesës perëndimore.



Zona karakterizohet nga një relief i i sheshte. Eshtë pjesë e një hapësire me një gjelbërim relativisht të ulët tip shkurresh.






Më poshtë gjenden koordinatat e objektit në studim në sistemin KRRGJSH dhe në sistemin Gauss Kryger.

KRGJSH		
Pikat	X	Y
1	494440.084	4510822.158
2	494450.024	4510830.838
3	494478.864	4510796.252
4	494468.924	4510787.858
5	494455.764	4510802.418
6	494450.724	4510797.798
7	494441.624	4510808.158
8	494446.664	4510813.198

GAUSS KRUGER		
Pikat	X	Y
1	4410095.11	4511497.24
2	4410105.15	4511505.81
3	4410133.6	4511470.89
4	4410123.56	4511462.61
5	4410110.57	4511477.32
6	4410105.47	4511472.76
7	4410096.49	4511483.22
8	4410101.59	4511488.21



Planifikimi funksional i zones

Zona ne te cilen do te zhvillohet kjo veprimtari, eshte nje zone e pelqyer per sipermarrjet me qellim sherbimi . Nga pikepamja urbanistike mund te themi se kemi te bejme me nje zone bujqesore.

Sipas klasifikimit te bere per vleresimin mjedisor te rajonit , kjo zone ndodhet ne nje zone te preferuar. Kjo zone eshte konceptuar si hapesire me karakter bujqesor.

Siperfaqja e ndertimit te thertores eshte 696.60 M2 dhe synon te jete nje ndertim i pajisur me te gjitha parametrat bashkohore te nje thertoreje.

Nga pikepamja e perceptimit urban objekti synon te promovoje vlera positive duke qene pjese e nje nyje urbane qe te stimuloje zhvillimet e metejshme te ketij karakteri.

OBJEKTIVAT E AKTIVITETIT:

❖ Objektivi i pare i ketij aktiviteti do te jete te identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore ketij instalime te cilat jane:

- Emetimet ne ajer dhe zhurmat;
- Ndikimi ne flore/faune;
- Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti i punetoreve;
- Ndikime social-ekonomike;
- Ndikim ne cilesine e jetes ne qendrat e banuara;
- Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor;
- Ndikim ne peizazhin e zones;

❖ Objektivi i dyte i ketij aktiviteti eshte gjetja e alternativave qe jane me miqesore me mjedisin.

PROCESI TEKNOLOGJIK

Operatori Muharrem Hoxha eshte nje subjekt i regjistruar dhe do te zhvilloj aktivitetin e saj ekonomik ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne fushen e rritjes se derrave dhe thertores. Qellimi i firmes mbetet permbushja e kerkesave te cilesise dhe per kete kompania ndjek dhe zbaton me rigorozitet menaxhimin e cilesise ne te gjitha hallkat e saj

LINJA E FUNKSIONIMIT TE THEROTRES

Procesi i punes fillon me pranimin e kafsheve (derrave) përpara procesit të therjes.

Pas pranimit, kafshët qëndrojnë në paratherje për tu ç'lodhur dhe i nënshtrohen procesit të urisë. Koha e qëndrimit në paratherje për bagëtitë e trasha është 24-36 orë në varësi të mundimit fizik, për bagëtitë e imëta është 12-24 orë në varësi të moshës, peshës trupore dhe mundimit fizik që kanë kryer. Bagëtisë në periudhën e urisë i ndërpritet ushqimi dhe i jepet ujë i cili ndërpritet 2-3 orë para therjes. Pushimi dhe periudha e urisë bëhet për shumë arsye teknologjike: shmangien e mundimit fizik dhe ngacmimeve nervore që ndikojnë në procesin e çgjakësimit, zvogëlimin e përmbajtjes së ushqimit në aparatën tretës gjë që ndikon në uljen e ngarkesës mikrobiale, lehtëson

proceset e mëtejshme të therjes si heqja e lëkurës, nxjerrja e organeve të brendshme etj. Gjatë trulllosjes nuk duhet që kafsha të humb funksionin e zemrës dhe organeve të frymëmarrjes pasi pengohet procesi i çgjakësimit duke bërë që të ulet cilësia e mishit. Trulllosja kryhet me këto mënyra: trulllosje mekanike konsiston në goditjen e bagëtive me mjetetë forta në rajonin ospital të kafkës së kafshës. Mjeti më i përshtatshëm që përdoret është vareja, një çekiç i rëndë prej dy kilësh në formë konike dhe me gjatësi bishti rreth një meter.

THERJA

Gjate procesit te therjes, kushtet e punes jane ne perputhje me parametrat e nevojshem teknike, teknologjine dhe rekomandimet e siguruara, ne bashkepunim te vazhdueshem me furnitoret, specialiste veterinare nga institucionet perkatese kombetare, nderkombetare, etj. Me konkretisht, ketu perfshihen: temperatura e mjedisit, sistemi i ventilimit, permbajtja e lageshtise, sasia e ndricimit, ngarkesa mikrobike e mjedisit, dhomat frigoriferike, sherbimet veterinare dhe kushtet shendetesore, si mjet parandalimi per te ruajtur mishin, nga infektimet apo semundje te ndryshme, qe mund te transmentohen si rezultat I neglizhences se masave te nevojshme

Kontrolli veterinar

Më pas vjen kontrolli veterinar, ky konsiston në kontrollin e mishit të bagëtive të cilat mund të jenë të prekura nga sëmundje të ndryshme si të mëlçisë, zemrës mushkërive dhe vetë mishit. Po ashtu kur mishi gjatë kontrollit del se është i prekur nga sëmundje veçohet dhe sipas vlerësimit të mjekut dërgohet për trajtime të mëvonshme të veçanta. Pas kontrollit veterinar mishi vulozet nga mjeku veterinar dhe vlerësohet nga teknologu cilësia e mishit, lloji i tij sipas standardit në fuqi dhe jepet destinacioni i duhur. Trupave të therur u bëhet edhe tualeti i cili është dy llojesh i njomë dhe i thatë. Tualeti i thatë konsiston në largimin e dhjamërave të barkut, pjesëve të gjakosura, gjëndrave të papërdorshme siushqim, absceset, mbeturinat e mishit të diafragmës, mbetje të trakesë dhe të ezofagut etj. Tualeti i njomë bëhet gjithmonë mbrapa atij të thatë, ai kryhet me anë të dushit ku mishi lahet me uje të freskët dhe të ftohtë me qëllim që të largohen të gjitha papastërtitë dhe gjakrat në sipërfaqe. Tualeti i njomë gjithashtu ka për qëllim uljen e temperaturës së mishit të porsatherur. Kujdes I vecante tregohet mbas tualetit të njomë mbasi bëhet tharja me lecke të thatë ose me ventilim sepse lagështia që ngelet rrezikon prishjen e mishit

LËNDËT E PARA DHE NDIHMËSE

Aktiviteti nuk është një aktiviteti i mirëfilltë prodhimi, prandaj nuk mund të flasim për lëndë të para për prodhim. Si lende e pare perdoret gjedhi. Lende ndihmese Uji dhe energjia Elektrike.

Gjithashtu per sa i perket qellimit tjeter : Qëllimi i projektit të propozuar është mbareshtrimi intensiv i derrave per prodhim mishi e cila do të zhvillohet ne nje kapanon industrial ekzistues.

Kompleksi per rritjen e derrave

Ne kete ekonimi te vogel mbajtja e derrit eshte e organizuar ne njesi te specializuara. Per keto njesi te vecanta ndertohen grup-stalla te ndara sipas moshave

- a- Grup stalla per rritjen e gicave deri ne dy muaj ne stallat e maternitetit
- b- Grup stallat per rritjen e gicave 2-4 muaj
- c- Grup i derrave per majmeri 6-8-10 muaj

Kompleks stalla ku rriten te gjitha moshat

Keto komplekse stalla projektohen:

- 1- Stalla maternitet ku mbahen dosat sebashku me gicat e tyre deri ne moshen 2 muaj me kapacitet per 12 krere dosa ne nje stalle
- 2- Stalla per dosa bares, per remont, per harc dhe stacion nderzimi
- 3- Stalle per derra ne majmeri me moshe 2-4-6-8-10 muaj me kapacitet per 700 krere derra ne nje stalle
- 4- Punishte ushqimi, depo dhe ambjente per punonjesit

Kompleks stalla te specializuara per nje kategori mishi te caktuar

Ne kompleks stallat e specializuara per nje kategori moshe, ndertohen vetem stalla maternitet dhe dosa bares e remonti ose vetem stalla per derrat ne majmeri.

Ne te dyja anet e stallave ndertohen padok por duke i projektuar rruge kalimi per furnizimin me ushqime ne mes te cdo padokeve.

- 1- Ne stallen e maternitetit merret 4.5 m² padok/cdo boks
- 2- Ne stallat per dosat bares dhe remonti merret 0.9 m²/koke
- 3- Ne stallat per harce merret 6 m²/koke
- 4- Ne stallat per derrat ne majmeri merret 0.7 m²/koke

Stalla e maternitetit per dosat ne laktacion

Ne stallen maternitet mbahen dosat e prodhimit, te cilat vendosen ketu 3 jave para lindjes dhe mbahen deri ne 2 muaj pas lindjes sebashku me gicat e tyre ne bokse te vecanta

Stalla maternitet eshte projektuar me kapacitet prej 50 krere dosa ne bokse te vendosura ne dy rreshta te grupuara dy e nga dy sipas skemes planimetrike me koridor qendror sherbimi.

Rrethimet anesore dhe ballore te bokseve mund te ndertohen te kombinuara me mure tulle dhe konstruksione metalike ose druri.

Lugu i ushqimit ne stallen e maternitetit ndertohet i vacante per cdo boks me gjatesi 60 cm per dosat dhe 140 cm per gicat.

Stalla maternitet duhet te jete e ngrohte, e ndricuar dhe e thate. Per te siguruar keto kerkesa ne projektimin e stalles maternitet perdoren keto norma tregues dhe koeficienta:

- Gjeresia e stalles maternitet projektohet 6-7 m me lartesi kati 2 m
- Koeficienti i ndricimit merret 1:12
- Temperatura mesatare brenda ne stalle duhet te jete 12-14 oC. Per kete arsye ndertohet tavan i pjerret.

Dyshemeja e bokseve ndertohet me materiale qe kane veti te mira termoizoluese, njekohesisht te jete i forte, e parreshqitshme dhe e padepertueshme nga lageshtia. Keto kerkesa i ploteson me mire dyshemeja e ndertuar me asfaltobeton ose pllaka bituminoze. Pjerresia e dyshemese duhet te siguroje kullim te shpejte te urines dhe te ujrave te larjes. Ne padok nxirren vetem gicat per te marre ajer te paster dhe rreze dielli, ndersa ne periudhen e veres ato ushqehen ne padok, prandaj aty ndertohen lugje ushqimi dhe lugje per te pire uje.

Teknologjia e mbareshtimit

Kjo teknologji eshte bashkimi i te gjitha metodave shkencore te punes, te karakterit zooteknik, veterinar, ekonomik, inxhinierik dhe elektronik, te lidhura ngushtesisht dhe qe bejne te mundur shtimin e prodhimit te mishit te derrit, me cilesi te mire dhe rentabilitet. Kryesore ketu eshte qe te shfrytezohet sa me mire vecorite gjenetike te derrave.

Hallkat e procesit jane:

1. Permiresimi racor
2. Menyra e te ushqyerit
3. Kujdesi per rritjen e derrave
4. Strehimi dhe mikroklima
5. Parambrojtja e shendetit te kafsheve

IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS

Mjedisi eshte gjithmone i prekur nga veprimtarite e ndryshme qe ushtrohen ne te, por ndikimi mund te jete i ndryshem, kjo eshte e lidhur ngushte me vete llojin e veprimtarise, e cila mund te kete impakt te drejtperdrejte, te terthorte, te rendesishem apo mesatar i pranueshem. Nga zhvillimi I aktivitetit pritet qe te kete shkarkime minimale ne mjedis, duke iu referuar edhe natyres se tij. Disa nga ndikimet e mundshme te ketij aktiviteti jane si me poshte vijon:

RREZATIMI JONIZUES

Nga zhvillimi i aktivitetit nuk kemi rrezatime jonizuese.

VIBRACIONET

Funksionimi i aktivitetit nuk shoqerohet me vibracione.

NDIKIMET NE POPULLESI

Zhvillimi i aktivitetit nuk do te shoqerohet me ndikime negative ne popullesi. Natyra e ketij aktiviteti nuk shoqerohet me shkarkime ne uje, ajer dhe toke qe mund te cenojne shendetin e banoreve te ndodhur aty prane. Ndikimet mund te jene pozitive duke i siguruar vende pune per banoret per rreth.

NDIKIMET NE AJER

Ushtrimi i ketij aktiviteti do te shoqerohet me shkarkime ne ajer te gazeve dhe pluhrave qe gjenerohen nga levizja e mjeteve te transportit ne ambjentet e jashtme te thertoresh, si dhe ne ambjentin ku ruhet gjedhi para therjes. Per sa i perket ketyre shkarkimeve do te jene ne vlera normale. Ambientet ku qendron gjedhi ajrosen shume shpesh. Punonjesis qe punojne ne ketë instalim jane te pajisur me veshje mbrojtëse (maska), me qellim uljen e ndikimit qe shkaktojne keto shkarkime ne shendetin e tyre. Gjithashtu mjetet e transportit qendrojnë te fikura ne momentin qe mberrijne ne subjekt, duke ulur ndjeshem gjenerimin e pluhrave dhe gazeve ne ajer

NDIKIMET NE TOKE

Ndikimet ne toke jane te uleta. Ne rast rrjedhje te substancave te ndryshme do te pastrohet menjehere sipërfaqja e kontaminuar.

NDIKIME NË UJË

Aktiviteti nuk shoqërohet me shkarkime në ujërat sipërfaqësorë.

NDIKIMET NE KLIME

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk priten ndryshime te dukshme klimatike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj. Nuk do kete ndryshime ne temperature, ne drejtim te eres, ne sasine e reshjeve. Pra kryerja e ketij aktiviteti nuk ndikon aspak ne kushtet klimaterike te kesaj zone.

NDIKIMET NE FLOREN DHE FAUNEN

Zona në te cilen ushtrohet aktiviteti është një zonë e cila ka nje bimesi te zhveshur. Gjithsesi Operatori do te shtoje siperfaqet e gjelberta rreth godines se subjektit per nje pamje vizuale me te kenaqshme per syrin dhe per te mirat ne pikepamjen mjedisore.

NDIKIMET NGA ZHURMAT

Zona ne te cilen zhvillohet aktiviteti ben pjese ne zone te pershtatshme per zhvillimin e aktivitetit. Aktiviteti nuk shoqërohet me gjenerime te larta te zhurmes. Nga funksionimi i aktivitetit nuk pritet te kete rritje te nivelit te zhurmave, aq me teper ndikime negative ne kete prizem.

NDIKIMET E AKTIVITETIT TE ZHVILLIMIT MBI NDERTIMET, TRASHEGIMINE ARKITEKTONIKE HISTORIKE DHE ZONAT E MBROJTURA

Aktiviteti që ushtron shoqëria zbatohet në një zonë në sipërfaqen e së ciles dhe në nëntokën e saj nuk ka ndertime lidhur me trashëgimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra te tjera njerezore. Gjithashtu aktiviteti do te zhvillohet nje nje distance te konsiderueshme nga zonat e Mbrojtura. Kjo tregon që zona është zonë e lirë për të realizuar kete aktivitet.

MBETJE

Mbetje jo të rrezikshme urbane

Nga zhvillimi i aktivitetit të punonjësve do te gjenerohen mbetje urbane me kodin 20 01 01; 20 01 02 dhe 20 03 01. Keto mbetje do te vendosen ne konteniere brenda territorit te aktivitetit, per t'u depozituar me pas ne vendet e perbashketa me Njesine e Qeverisjes Vendore. Kontenieret do te jene me ngjyra ne menyre qe mbetjet te ndahen qe ne burim, gjithashtu edhe te mbyllur, per te

evituar perhapjen e aromave te pakendeshme sidomos ne kohe me temperature te larte dhe ne kontakt me lageshtiren.

Mbetje nga aktiviteti i therjes

Mbetjet e gjeneruara nga proceset e therjes te tilla si ato me kode 02 02 02 ; 02 02 03 ; 02 02 99, fillimisht vendosen ne konteniere te posacem, te ndara sipas kodeve. Kontenieret etiketohen dhe evidentohen dhe ne momentin qe eshte arritur kapaciteti i mbetjeve i rene darkort mes paleve (gjenerues I mbetjeve - asgjesues I mbetjeve), ky I fundit njoftohet per te kryer terheqjen e mbetjeve. Pasi subjekti i licensuar i terheq mbetjet nga ambientet e zhvillimit te aktivitetit, ai ben te mundur menaxhimin, trajtimin ose asgjesimin e tyre.

□ **NDIKIMI SOCIAL-EKONOMIK**

Zhvillimi i aktivitetit ka sjelle dhe do vazhdoje te sjelle nje rritje nga ana ekonomike e zones, kjo per dy arsye si tatimpagues i Njesise se Qeverisjes Vendore dhe si nje biznes qe ka punesuar dhe do vazhdoje te punesoje individe te zones

REKOMANDIMET

Toka

Perdorimi i tokes

Kryerja e aktivitetit brenda koordinatave te percaktuara

Zbatimi i kushteve teknike dhe standarteve

Mirembajtja dhe gjelberimi i siperfaqes

Biodiversiteti

Vegjetacioni

Mirëmbajtja e kurorës së pemëve dhe bimësisë së mjedisit në përdorim nga shoqëria sic eshte e parashikuar ne legjislacionin per instalime te tilla.

Mbjellja e fidaneve te rinj, pergjate rruges qe ben te mundur hyrjen per ne object dhe ne te gjithe perimetrin e tij.

Cilesia e Ajrit

Emetime nga mjetet e transportit

Mbajtja fikur e automjeteve gjate ngarkim-shkarkimit te cimentos dhe pjeseve te automjeteve ne ambientet e instalimit

Mbetjet

Menaxhimi I mbetjeve

Vendosja e kontenierëve në brendësi dhe jashtë objektit, diferencimi i mbetjeve sipas fraksioneve të gjeneruara dhe transportimi periodik i tyre në vendepozitimin më të afërt të caktuar nga njësia vendore.

Terhqja nga operatore te licensuar e mbetjeve nga proceset e punes.

Zhurmat

Niveli i zhurmave

Operimi brenda orareve të caktuara, nga rregullorja e punës.

Përdorimi i mjeteve të punës dhe të transportit gjat orareve të përshtatshme.

Trafiku rrugor

Mbetjet e gjeneruara nga zhvillimi I aktivitetit kane te bejne me jashteqitjet, ujerat e ndotura apo me mbetjet urbane qe krijohen nga kjo veprimtari.

Mbetjet e ngurta urbane si plastike, qelqi, materiale letre, metale, mbetje organike (paleta druri). Referuar VKM Nr. 402, date 30.06.2021 "Per miratimin e katalogut te Mbetjeve", mbetjet qe prodhohen klasifikohen me kodet:

20 01 01 Leter dhe karton;

20 01 02 Qelq;

20 01 39 Plastiket;

20 01 40 Metalet;

02 01 09 Mbetje bujqësore, përveç atyre të paraqitura në rubrikën 02 01 08

02 02 01 Llumra që vijnë nga larja dhe pastrimi

02 02 02 Mbetje që vijnë nga indet shtazore

02 02 03 Materiale të papërshtatshme për konsum apo për përpunim

02 02 04 Llumra që vijnë nga trajtimi në vend i rrjedhjeve 02 02 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara

SHKARKIMET NE UJE

Nuk kemi ndotje te ujerave nentokesore.

Ujerat qe dalin nga aktiviteti ne objekt jane ujera urbane, te cilat do te grumbullohen fillimisht ne grope septike dhe me pas do te lidhen me sistemime kanalizimeve te zones. Gjithashtu mund te kete edhe ujera te larjes se ambienteve perreth objektit, por qe nuk vleresohen me perberje te elernenteve ndotes per mjedisin. Nepermjet NJ.Q.V, subjekti duhet te plotesoje kriteret e lidhjes se sistemit te kanalizimeve dhe duhet te kete projektuar mire menaxhimin e sistemit te kanalizimeve dhe te furnizimit me uje te pijshem per situaten e re vecanerisht gjate sezonit veror, ku fluksi i pushuesve eshte shume i larte.

EMETIMET NE AJER

Emetime ne ajer nga funksionimi i kesaj veprimtarie ka te beje vetem me ambjentin ku do te vendosen kafshet. Sistemi i ngrohjes do te jete me ajer te kondicionuar.

ZHURMAT DHE VIBRIMET

Emetime te zhurmave nga funksionimi i ketij objekti nuk do te kete. Objekti eshte me funksion banim dhe hoteleri, nuk do te kete aktivitete qe leshojne zhurma ne mjedis.

MBETJET E PRODHUARA

Do te caktohen vende te caktuara ne te cilat do te behet grumbullimi i mbetjeve nga zhvillimi i veprimtarise. Ky grumbullim i mbetjeve do te behet cdo dite nga kontraktori ne mbikqyrje te administratorit. Ndersa per mbetjet urbane ne fund te dites se punes ato do te mblidhen dhe do te largohen per ne vendin e percaktuar nga Pushteti Vendor

NDIKIME TE TJERA

Gjate funksionimit te objektit, ne rast se do te ndertohen ambiente me sistem ngrohje rekomandojme perdorimin e energjise elektrike dhe ose gazit te lengshem te naftes, si lende djegese. Rekomandojme qe objektit ose ambienteve ne vecanti, t'u kryhet termoizolim per te kursyer energjine ne ngrohje dhe ne ftohje, si dhe perdorimin e energjise elektrike ose te sistemit te kaldajave me gas. Menaxhimi i sistemit te ngrohjes dhe izolimi i ambientit ndikon ne menyre te drejtperdrejte ne uljen e konsumit te energjise dhe si rrjedhoje edhe ndotjen e teknologjise se prodhimit dhe transmetimit ose transportimit te burimit te energjise. Gjithashtu persa i perket sistemit te ndricimit, rekomandojme projektimin e nje skeme ndricimi natyral sa me shume te jete e mundur, ne menyre qe te reduktohen oret e ndricimit artificial ne objekt. Aplikimi i teknologjive me te reja dhe ekonomike ne fushen e ndricuesve artificial si llambat LED, sistemet e ndezjes dhe fikjes automatike etj.

Rekomandime

Duke ditur se gjate proceseve te punes emetohet në mjedis pluhur i lehte, ka zhurma te makinerive për të rritur sigurinë në punë të punonjësve dhe per te ulur ne maksimum impaktin ne mjedis, duhet të:

1. Te behet monitorimi I vazhdueshem i ujerave te ndotur
2. Te behet monitorimi periodik i mbetjeve nga therjet e kafsheve
3. Te behet monitorimi periodik i mbetjeve qe do te grumbullohen si dhe atyre urbane
4. Te behet monitorimi periodit i ujerave ne gropern septike.
5. Te behet monitorimi periodik i emetimit te zhurmave ne mjedis.
6. Te behet monitorimi periodik i emetimit te pluhurit ne ajer.
7. Te njihen punonjesit periodikisht me rregullat e sigurimit teknik.
8. Te pastrohen dhe mirembahen kanalet e drenazhimit te ujerave perreth perimetrit dhe ujit te lagunes ku do te behet hedhja e gureve per ndertimin e peneleve.
9. Te kontrollohet kompletimi me mjete mbrojtese nga zjarri.
10. Te respektohen normat e teknikes se sigurimit ne pune nga punetoret.

Te behet rregullisht monitorimi i gjendjes teknike te automjeteve

Inxhinier mjedisi
Ing M.Sc Ina Bora

